

PRAVUAR ME  
ACCEPTED ON  
PRIMLJENO:

20.06.2023

Mj. No. Br.

02 | 315



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Nr. 02/  
Datë: 19.06.2023

**PROCESVERBAL**

i mbledhjes së -V- (pestë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa

**RENDI I DITËS**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e katërt e rregullt e mbajtur me datë: 24.04.2023.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e komunës së Malishevës.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të Punës së Kryetarit të Komunës (Janar-dhjetor) 2022.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Drejtorisë për Bujqësisë, për mbjelljet pranverore.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit komunal për integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunën e Malishevës
6. Shqyrtimi i kërkesave.
7. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 23.05.2023 dhe filloi në ora: 10:30. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi, Drejtori për Bujqësi Sylë Dukolli, përfaqësues nga Drejtoria për Shërbime Publike Naser Morina, zyrtarja për Komitete dhe kthim Edona Krasniqi, Zyrtari ligjor Muharrem Morina, antarët e komisionit: Gentianë Hoti, Rukije Bytyqi, Veton Zogaj, Sadik Vrenezi, Arlinë Rudi, dhe zyra për informim.

**Argjend Thaçi:** Përvendetje për të gjithë dhe mirë se keni ardhur!

Hapi mbledhjen e -V- (pestë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa. Aktualisht prezent në mbledhje jemi 6 antarë, dhe mund të vazhdojmë me punimet e mbledhjes.

Si pikë të re të rendit të ditës propozoj shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për vlerësimin dhe kompenzimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësítë natyrore/elementare në bujqësi në komunën e Malishevës. A keni diqka të shton si i përket rendit të ditës. Nëse nuk keni diqka, shkojmë në votim të rendit të ditës së bashku me pikën e propozuar. Kush është për?

Me vota unanime, miratohet rendi i ditës.

Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës: shqyrtimim dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. Kush është për?

Me vota unanime, miratohet procesverbali.

Kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e komunës së Malishevës. Prezent e kemi zyrtarë e drejtorisë për Shërbime Publike Naser Morina. Urdhëro, Naser!

**Naser Morina:** Përshëndetje për të gjithë!

Uë kam qenë pjesmarrës në hartimin e kësaj Rregullore, në grupin punues dhe si komunën e Malishevës këtë Rregullore e kemi për herë të parë. Jemi duke e përpiluar dhe Planin komunal 5 vjeçar për menaxhimin komunal të mbeturinave. Ai Plan do jetë më i detajuar, do ketë të dhëna më përbajtësore. Së pari është dashur ta aprovojm këtë Rregullore, pastaj Planin. Ne jemi duke tentuar që kompetencat me i kthy në kuadër të komunës, që aktualisht këtë kompetencë e ka Ekoregjioni. Të gjitha mjetet që qytetarët i paguajnë shkojnë në Ekoregjon. Pra, kjo Rregullore qëllimin kryesor e ka kthimin e kompetencës nga kompania, në përgjegjësi të komunës.

Janë paraqitur dhe disa tarifa për ekonomin familjare, sepse këtë reform fillimisht e kemi bërë vetëm për ekonomin familjare, ndërsa bizneset do të kenë kontratat e veqanta me Ekoregjonin, ndërsa komuna me u marr vetëm me ekonomi familjare.

Këtu i kemi paraqitur dhe disa tarifa tjera për bizneset e vogla dhe të mesme. Propozimi ka qenë me 5.5 për ekonomi familjare 5 euro e 50, ndërsa aktualisht është 4 euro e 50. Njëri ndër anëtarët e grupit punues nga Ekoregjioni ka kërkuar 6 ose 6.5 të bëhet, mirëpo është nivel komunal se si përcaktohet dhe jo anëtarët e kompanive me na propozu qmimet.

Kjo Rregullore i përcakton dhe përgjegjësitë e komunës, në këtë rast dhe të operatorëve. Të gjitha mbeturinat janë të përfshira, përmos mbeturinave që janë të rrezikshme dhe janë kompetencë e qeverisë dhe disa mbeturina që nuk i kemi përfshirë siç janë vajrat, gomat, eshtrat nga mishtoret. Mbetet me ndonjë draft tjetër të marrim vendim.

Mbeturinat e përzira komunale në bujqësi dhe mbeturinat e rrënimit janë të parapame në këtë Rregullore.

**Rukije Morina:** Pse nuk janë përfshirë këtu dhe eshtrat?

**Naser Morina:** Ka disa komuna nëpër takime i kanë bërë disa lokacione, por nuk i kanë trajtuar në mënyrën e duhur, dhe AVUK ju ka heq atë të drejtë, sepse nuk janë trajtuar sipas standardeve. Eshtrat duhet t'i trajtojnë kompanitë që kanë licencen për themje dhe për punimin e këtyre.

**Veton Zogaj:** Ai licencoitet dhe pastaj i dërgoni dhe i asgjeson tek ai.

**Rukije Bytyqi:** Në Malishevë nuk ka një vend se ku të hudhen, dhe po kemi probleme pastaj dhe me qentë endacak, sepse eshtrat po hudhen pa vend.

**Naser Morina:** Gomat, vajrat, produktet medicionale, qeveria do i merr disa kritere se si do bëhet.

**Argjend Thaçi:** As gjami nuk ka ku të hudhet.

**Naser Morina:** Sa i përket gjamave janë disa kompani që kanë filluar dhe mundesh me i dërgu atje.

**Veton Zogaj:** Jam munduar me e krahasuar me Rregulloret që janë të miratuara në kuvendet komunale dhe kjo e jona është copy prej Therrandës, dhe është një pjesë që nuk ja keni larguar hiq Kuvendi Komunal i Therandës.

Te neni 13 mund të na sqarosh është pika e fundit: nëse qmimi i energjis elektrike do të ndryshojë, do

ndryshojë dhe shuma maksimale 15E, sipas përqindjes së ndryshimit. Ne mund të ja japim dritën jeshile për me dërgu në Kuvend, dhe ne si grup pastaj i dërgojm dhe të shkruara vërejtjet.

Sa i përket shumës që është kërkuar prej 4.5 në 5.5, unë nuk jam për me ngrit në këtë fazë, sepse Prishtina e ka 4.50. Është mirë me u paraparë në këtë Rregullore që secila ekonomi familjare me u pajis me kontinjer që klasifikon mbeturinat, sepse kam pasur shumë ankesa në të kaluarën që kompania një pjesë të mbeturinave nuk i ka marrë. Sa e di është ndarë vitin e kaluar një lokacion si deponi.

**Naser Morina:** Pika e transferit është Në Drenoc, Stapanicë, Llapqevë dhe në Banjë deponit.

**Veton Zogaj:** Këto mbeturinat inerte, ne si komunë më duket nuk kemi. Si sugjerim për këtë Rregullore e kisha dhënë që të niset dhe pastrimi i rrugëve në qytet, por dhe në fshatra. Vetëm këtë nenin 13, nese ke muhdësi një sqarim.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Gentianë!

**Gentianë Hoti:** Unë dua të nderlidhem këtu te qendra në Malishevë. Te lagjja Mirdita, nuk bëhet mbledhja e mbeturinave çdo ditë siç bëhet mbledhja në qendër. A keni paraparë që çdo ditë të merren mbeturinat, ose me vendos kontinjer, sepse banorët nuk kanë ku t'i hudhin mbeturinat. Në lagjen Mirdita një herë në javë i marrin mbeturinat, sikur në fshatrat tjera.

**Naser Morina:** Për ekonomi familjare mbledhja e mbeturinave është një herë në javë, ndërsa për biznese është çdo ditë dhe banimet kolektive shërbehen me kontinjer të përbashkët. Veton, e përmendi që është taksa e lartë dhe e përmendi Prishtinën, mirëpo disa komuna e kanë taksën më të ulët, sepse deponin e kanë më afër, ndërsa komunat e tjera e kanë 5.5 ose 6. Kompania e kryen shërbimin, ndërsa ne do ta kontraktojmë kompanin për kryerjen e shërbimit ndërsa taksën duhet ta merr komuna.

**Veton Zogaj:** Kontinjerët që i blejm vetë, kam informacione që po dëmtohen dhe nuk jepet kurrfar përgjegjësie.

**Naser Morina:** Këtë qështje do ta precezojmë në kontratën e radhës që do ta lidh komuna me kompaninë. Sa i përket klasifikimit dhe atë jemi duke u munduar më bërë dhe i kemi disa hapa. Kem kompani të interesuar për letër, qelq dhe plastik dhe kompanit që janë të interesuar munden me dërgu shporta nëpër fshatra. Nëpër shkolla kemi filluar këtë projekt, i kemi 6 shkolla dhe kemi lidhur dy marrveshje me kompanitë për kapaka të shisheve dhe për kanaqe dhe shkollat e kanë vendin ku i dërgojnë ato dhe është paraparë dhe çmimi që do i paguhet nxënësve dhe kjo është si fushatë vetëdisuese. Kjo do bëhet në të gjitha shkollat fillimi, e pastaj dhe në ekonomi familjare nëse ka biznese të interesuara për këtë punë.

Te pika 13 këtu kemi menduar siç e thashtë për ekonomi familjare që janë rezidente 5.5, ndërsa për diasporën e kemi bërë një formul që janë duke e bërë gjitha komunat, në bazë të karteles së KEK-ut.

**Rukije Bytyqi:** Barin dhe disa gjëra tjera kompani nuk i merr.

**Naser Morina:** Bari, dheun, mbetjet nga krasitja e drunjëve, kompania nuk i merr. Pastrimi i rrugëve është paraparë në Rregulloren komunale dhe e kemi dhe një kontrat një vjeqare për pastrimin e rrugëve.

**Rukije Bytyqi:** Një projekt ka qenë më herët që disa punëtorë janë punësuar nëpër lagje, ajo ka funksionuar shumë mirë.

**Argjend Thaçi:** Kush është për që të rekomandohet për Kuvend Rregullorja përmenaxhimin e mbeturinave në territorin e komunës së Malishevës. Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

**Kalojmë në pikën tjetër:** Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të Punës së Kryetarit të Komunës (Janar-dhjetor) 2022. Kryetari nuk ka mundur të vijë sepse është në një takim në Prishtinë.

**Veton Zogaj:** Po e rekomandojmë për Kuvend, dhe pastaj aty diskutojmë.

**Argjend Thaçi:** Kush është për që të rekomandohet për Kuvend, Raporti vjetor të Punës së Kryetarit të Komunës (Janar-dhjetor) 2022.

Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

**Kalojmë në pikën tjetër:** Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Drejtorisë për Bujqësisë, përmbylli jet pranverore. Prezent kemi Drejtorin për Bujqësi Sylë Dukolli. Urdhëro, drejtor!

**Sylë Dukolli:** Përshendetje për të gjithë!

10 deri në 12% është shtuar sipërfaqja e mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore. Në të gjitha kulturat kemi shtim të numrit të hektarëve dhe të fermerëve që kanë aplikuar dhe që janë duke e mbjetë tokë. Ka qenë një vetëdisim, ndoshta dhe për shkak të krizës që ishte globale. Në qoftëse mesatarisht i kemi produktive këto e që janë të mbjella të shëndosha. Malisheva po i plotësojke kërkesat përbukë, nëse nuk transporton jashtë komune.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit, drejtor! Urdhëro, Veton!

**Veton Zogaj:** A ka pasur në këtë vit subvensionim përfara dhe plehra.

**Sylë Dukolli:** Jo, nuk ka pas.

**Veton Zogaj:** Unë mendoj që tanë në buxhet duhet me paraparashihen këto subvensionime.

**Sylë Dukolli:** Në disa takime që i kam pasur në Ministri, më kanë thanë që disa komuna dhe ju po i mbështetni ata që dhe ne po i mbështesim.

**Argjend Thaçi:** Kush është për rekomandim për Kuvend, Planin e punës së Drejtorisë për Bujqësisë, përmbylli jet pranverore?

Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

**Kalojmë në pikën tjetër,** e cila u fut si pikë e re e rendit të ditës: shqyrtimi dhe miratimi i Raportit përvlerësimin dhe kompenzimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore/elementare në bujqësi në komunën e Malishevës. Urdhëro, drejtor!

**Sylë Dukolli:** Kjo ka lindur si shkas për shkak të temperaturave të ulta dhe shirave të shumtë që kanë qenë në vendin tonë. Gruri është i prekur, mirëpo më së shumti është prekur kumbulla, dhe nësë vazhdon kështu do dëmtohet dhe druri jo vetëm fruti. Ne e kemi bërë komisionin, ka shkuar në teren, kanë bërë vlerësimin e shkallës së dëmit dhe ky Raport duhet të kalojë në asamble dhe pastaj kryetari i komunës së bashku me mua me ju drejtu një komisioni përfatkeqësi natyrore. Sot e morëm lajmin që dhe mollat kanë dërmtime në frut.

**Veton Zogaj:** Ne mundemi me rekomanndu për Kuvend. Unë kisha sugjeruar që nëse ka dhe tjerë të dëmtuar unë kisha thënë që të futen të gjithë.

**Argjend Thaçi:** Kush është për, që të rekomanndohet për Kuvend Raporti për vlerësimin dhe kompenzimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitetë natyrore/elementare në bujqësi në komunën e Malishevës?

Me vota unanim, kjo pikë rekomanndohet për Kuvend.

Kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit komunal për integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunën e Malishevës. Prezent e kemi zyrtaren për Komunitete Edonë Krasniqi.

**Edonë Krasniqi:** Përshëndetje për të gjithë!

Në kuadër të Agjendës Evropiane të Kosovës, kriteret nga Udhërrëfyesi për liberalizimin e vizave të përcaktuara në blokun 0, ripranimi dhe riintegrimi tashmë janë përbushur.

Gjatë hartimit të strategjisë, janë adresuar të gjitha kërkesat që dalin Programi Kombëtar për zbatimin e MSA-së.

Strategja e Ri integrimit ka për qëllim ri integrimin e qëndrueshëm socio-ekonomik të personave të riatdhesuar përmes avancimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të një sistemi efektiv e efikas të shërbimeve, të fokusuar në nevojat e të kthyerive. Strategjia, si dokument qeveritar i politikave të ri integrimit është obligative të zbatohet në tëre territorin e Republikës së Kosovës. Në kuadër të Planit te Veprimit te Strategjisë është paraparë edhe hartimi i Planeve Komunale për Ri integrim të qëndrueshëm. Me qëllim të zbatimit të koordinuar në praktikë të Strategjisë për Migrim 2022 - 2025, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) në bashkëpunim me Drejtoretë Komunale si dhe me përfaqësuesit e organizatave vendore e ndërkombëtare, si Grupi Punues, kanë hartuar Planin Komunal për ri – integrim të qëndrueshëm dhe Integrimin e të huajve për Komunën e Malishevës. Plani i Veprimit përmban objektivat, aktivitetet konkrete dhe masat për arrijen e objektivave, përcakton institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për arrijen e secilit objektiv, saktëson kornizën kohore për realizimin e secilit aktivitet, koston e përafërt financiare për zhvillimin e aktiviteteve, indikatorët matës të objektivave dhe aktiviteteve dhe mjetet e verifikimit.

Plani është hartuar në bazë të Strategjisë për Mingrim 2021 – 2025, Rregulloren (QRK) Nr.22/2020 Për Riintegrinin e personave të Riatdhesuar si dhe bazuar në Rregulloren për Integrinin e të Huajve (Rregullore (QRK) Nr. 09/2019 për integrimin e të huajve është miratuar në mbledhjen e 110 te Qeverise së Kosovës, me vendimin nr. 01/110, datë 11.07.2019) dhe Planit të veprimit në nivel shtetëror, në bashkëpunim të ngushtë me MPB/DRPRIH si institucion përgjegjës për ri-integrin në nivel nacional, dhe në vete ngërthen strukturën e saj, mirëpo duke pasur parasysh se ka të bëjë me nevojat e personave të riatdhesuar në Komunën e Malishevës, përmban edhe aktivitetet specifike për vetë komunën dhe është e bazuar në të dhënrat e siguruara nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim. Kështu, ne këtë Plan është mundësuar integrimi maksimal i gjitha aktiviteteve për arrijen e riintegrimit të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunën e Malishevës. Ky Plan ka 11 objektiva.

**Veton Zogaj:** A është bërë për herë të parë ky Plan?

**Edonë Krasniqi:** Jo është për herë të dytë ky Plan, vetëm së para tre viteve ka qenë vetëm për rintegrin , ndërsa tanë është dhe për integrimin e të huajve dhe Rregullorja është e re.

**Veton Zogaj:** Atë Rregullore a ke mundësi me na sjellë në Kuvend, që ta krahasojmë Planin me Rregullore. A ka raste që kthehen dhe paraqiten në zyren e juaj?

**Edonë Krasniqi:** Kemi raste, zakonisht të gjitha ndihmat shkojnë nëpërmjet Ministries së Punëve të Brendshme.

**Veton Zogaj:** Sa raste janë në vit?

**Edonë Krasniqi:** Në vitin 2014-2015 i kemi pasur 130 raste që janë kthyer, ndërsa tani i kemi shumë pak raste.

**Veton Zogaj:** A kemi raste të të huajve?

**Edonë Krasniqi:** Si komunë të të huajve nuk kemi pasur asnjë rast dhe pse si Kosovë kemi raste kogja shumë, mirëpo vetëm si tranzit.

**Argjend Thaçi:** Kush është për, që të rekomanohet për Kuvend Piani komunal për integrimin e qëndrueshmët personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunën e Malishevës?  
Me vota unanime, kjo pikë rekomanohet për Kuvend.  
Kalojmë në pikën tjetër, shqyrtimi i kërkesave

**Rukije Bytyqi:** Kryesues, para se të hyjmë te këkresat, është mirë që dhe ne t'i kemi këto ose në email ose fizikisht.

**Gentianë Hoti:** Më mirë është t'i kemi sidomos kërkesat për ndërrim të pronës.

**Veton Zogaj:** Këto kërkesat për ndërrim destinime duhet të na vinë dhe neve që t'i shikojmë.

**Argjed Thaçi:** Pa një sqarim paraprak, kjo nuk do të kalonte. E kemi një përgjigje të shkresës përcjellëse të Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër bazuar në shkresën përcjellëse nr.02/518 të datës:23.12.2019 zyrtarët përgjegjës kanë dalur në teren për të bërë rivelimin e parcelave për të cilat është bërë kërkesa për këmbim. Bazuar në rivelimin e parcelave jepim këto të dhëna: parcela me numër 72310050-00433-1 pronë private e cila evidentohet në emër të Murtez Feriz Thaçi, Sahit Adem Thaçi dhe Flurim Nezir Thaçi, me kulturë livadh i klasës 4, zona kadastrale Mirushë me sipërfaqe të përgjithshme prej 3644m<sup>2</sup>, sipas matjeve të kryera në teren vërehet që sipërfaqja prej 2100m<sup>2</sup>, kohë pas kohe dëmtohet nga rrjedha e Lumin Mirusha, përkatesisht rrjedha e digës. Së bashku me këto të dhëna do ju përcjellim dhe skicen e matjeve dhe qerifikaten e pronës të pronave private. Po ashtu, kësaj shkrese ia bashkangjesim edhe dokumentet e pronave komunale të lira të cilat pas shqyrtimit nga organet përgjegjëse mund të propozohet për këmbim. Ata ju kanë kthyer shkresës së vjetër dhe nuk ju na kanë kthyer në bazë të protokolit që ju kemi dërguar. Ata na kanë dhënë opzionet se ku mundet me ju dhënë prona.

**Veton Zogaj:** Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër e ka kthyer, por jo në propozimin që e ka kërkuar ky.

**Argjend Thaçi:** Gjeodezia ka dhënë 3 parcela ku mundet me u këmby. Kush është që kjo kërkesë të rekomanohet për Kuvend?

Me vota unanime, kjo pikë rekomanohet për Kuvend.

Kërkesa tjetër është nr.02/201 nga kryesia e fshatit Bellanicë, të cilët kërkojnë nga Drejtoria për

Gjëodezi, Kadastër dhe Pronë që të dalë në teren në fshatin Bellanicë, përkatësisht në vendin Bregu i Urës që të bëjë ingjizimin e parcelave publike, matjen e rrugës së asfaltuar, si dhe konstatim të rrugëve të tjera të cilat do bëhen për nevoja të ndryshme të qytetarëve. Me qëllim që kjo pjesë mos të keqpërdoret nga persona fizik apo dhe juridik. Kërkojm nga ju si drejtori që të gjith parcelat e paraqitura në numra të ndryshëm të bëhen në një parcel të vetme me një numër kadastral.

**Veton Zogaj:** Kjo kërkesë duhet të rekomandohet për Kadastër dhe me një numër kadastral nuk mund të bëhet.

**Argjend Thaqi:** Kush është që kërkesa nr.02/201 të rekomandohet për Drejtorin për Gjëodezi, Kadastër dhe Pronë?

Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për drejtorin për Gjëodezi, Kadastër dhe Pronë.

Kalojmë në kërkesën tjetër 01/385, e parashtruar nga Adam Hoti. Kryesia e fshatit Carrallukë-në bazë të kërkesës së bashkëfshatarit tonë Adem Hoti për dhënien e pëlgimit për ndërtimin e shtëpisë-arsytime duke i marrë parasysh gjitha rrethanat e gjendjes shumë të rënduar ekonomike kryesia e fshatit jep pelqim, që të drejtorojmë këtë kërkesë për lejimin dhe zyrtarizimin e 5 ari tokë për ndërtimin e shtëpisë në lokacionin ku është duke jetuar momentalisht.

**Gentianë Hoti:** Halil Kastrati po e ndihmonë me ja ndërtu shtëpinë, sepse i ka kushtet shumë të rënda.

**Argjend Thaqi:** Ne duhet të pajisemi dhe nga Drejtoria e Gjëodezis me disa dokumentacione, një dokument ja kam këruar që nuk ka pronë të veten dhe pastoj flasim me Gjeodezinë ku është ndonjë pronë e mundshme.

**Gentianë Hoti:** A mundemi ne me dërgu në Kuvend, e pastaj këta ta kompletojnë lëndën.

**Argjend Thaqi:** E kemi dhe një kërkesë të ngjajshme nr.02/637 datë:22.12.2022 e parashtruar nga Arijon Krasniqi, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, për ndërtimin e një shtëpie, për banim familjar. Kush është për që të rekomandohen për Kuvend, kërkosat nr.02/385 dhe nr.02/637?

Me vota unanime, këto dy kërkesa rekomandohen për Kuvend.

Kërkesa tjetër është nr.02/237 e parashtruar nga organizata e pensionistëve dhe Invalidëve të punës së Malishevës. Duke e analizuar gjendjen financiare të Organizatës së Pensionistëve dhe invalidëve të punës së Malishevës ju drejtohum juve që të na ndihmoni me ndihmë financiare në vlerë prej 2500E për vitin kalendarik 2023. Zyra e kësaj organizate të vëtmin burim financiar e ka nga të hyrat e antarsisë dhe me këto të hyra ne mezi e mbajmë mirmbajten e llogarisë bankare, të cilën e kemi të hapur si organizatë. Sipas Planit që kemi si organizatë na duhet mbështje me ndihmë financiare. Ne këtë kërkesë ja rekomandojmë zyrës së kryetarit. Kush është për që kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvend?

Për: 5

Kundër: 0

Abstenim: 1

Kërkesa tjetër është 02/239 nga Komiteti për shëndetësi, mirëqenie sociale dhe persona me aftësi të veqanta. Komiteti për shëndetësi, mirëqenie sociale dhe persona me aftësi të veqanta në mbledhjen e mbajtur me 24.03.2023, pas shqyrtimit të propozimeve të anëtarëve të Komitetit ndër të tjera për

Kuvendin komunal, propozojë dhe këtë rekomandim që Komuna e Malishevës me vite të tëra ballafaqohet me epidemin e eteve hemoragjike. Stafi i emergjencës në periudhën prill-gusht është i tejngarkuar me këtë problematikë, dhe anëtarët e Komitetit unanimisht vendosën që t'i drejtoohemi Kuvendit të Malishevës për mbështetje financiare për stafin e shërbimit të emergjences në kuadër të QKMF-së. Rekomandojmë që për 25 mjek dhe infermjerë të stimuloohen me mjete financiare në shumën prej 5.000E gjatë tërë periudhës së ballafaqimit me këtë epidemi.

Kush është që kjo kërkësë të rekomandohet për zyrën e kryetarit?

Për: 1

Kundër: 0

Abstenim: 5

Kërkesa tjetër është nr.02/206, nga Shefshet Xhafer Berisha dëmtim i pronave nga ujrat e zeza. Para disa viteve 17,19,2018 kam regjistruar ankesë me shkrim në Komunën e Malishevës, për dëmtim të pronës sime në fshatin Berishë me numrat kadastral 00308-0,00309-0 dhe 00310-0, por që nuk kam marr asnjë përgjigje lidhur me dëmin që janë duke e shkaktuar ujerat e zeza të cilat derdhen në këtë hapsisë private. Ne kemi kërkuar që të merren masat e duhura edhe të mos infektohen ujërat e pishme natyrore që gjenden në pronën time sikurse krojet dhe perrojet.

**Veton Zogaj:** Unë e kam vizituar dhe ky është pensionistë dhe po jetojke në Amerikë. Ato që janë të shënuara janë të vërteta, sepse ajo sipërfaqe vërtet është degraduaar dhe janë dy kroje të fshatit që janë kontaminuara. Është mirë me ju drejtu Drejtorisë së Urbanizmit.

**Argjend Thaçi:** Kush është për që kërkesa nr.02/206ti dërgohet drejtorisë për Urbanizëm dhe Drejtorisë për Shërbime Publike?

Me votat unanime, kjo kërkësë rekomandohet për Drejtorin për Urbanizëm dhe Drejtorin për Shërbime Publike.

Kërkesa tjetër është nr.0/231 nga Rifat Murat Kryeziu, i cili kërkojnëqë të mundësohet asfaltimi i rrugës që quhet Rifat Murati në gjatësi afersisht 80m. Të bashkangjitur keni dhe foton e nxjerre nga gjeoportali ku shihet rruga që duhet asfalltuar. Kush është për që kjo kërkësë të rekomandohet për Drejtorin e Urbanizmit?

Me vota unanime, kjo kërkësë rekomandohet për Drejtorin e Urbanizmit.

Kërkesa tjetër është nr.02/247 e parashtruar nga Gentrit Krasniqi, për ndihmë financiare për vajzën e tij Rinesa Krasniqi, e cila është dukë u përballur me diagzoza: laringomalatia congenitála, anaemia sideropenica, hypotonia muskulare susp. Te bashkangitura i keni të gjitha reportet mjeksore.

**Gentianë Hoti:** Ky rastë është i rëndë, siç është mirë kjo rrëzohet për toke, është mirë që ta dërgojmë në Kuvend.

**Argjend Thaçi:** Kush është për që kërkesa nr.02/247 të rekomandohet për Kuvend?

Me vota unanime, kjo kërkësë rekomandohet për Kuvend.

Kërkesa tjetër është nr.02/147 dhe kërkesa nr.0/129 janë kërkësë të kancerit unë ju kam treguar se për momentin nuk mundemi me i dërgu në Kuvend dhe po ju ndajmë nga 500E.

Kush është për që këtyre dy kërkësave të ju ndahm nga 500E?

Me vota unanime, këtyre kërkësave ju ndajmë nga 500E.

Kërkesa tjetër eshtë nr.02/131 Halil Helshani, i cili kërkon ndihmë financiare për mbulimin e kulmit të shtëpisë. Po ja ndajmë 500E. Kush eshtë që kësaj kërkesë të ja ndajm 500E?

Me vota unanime, kësaj kërkesë i ndahan 500E.

Kërkesat tjetër eshtë nr.02/158, i cili kërkon ndihmë financiare për djalin i cili vuan nga lëndimi dorës dhe lëndimi në fëtyre, unë si baba jam i pa punë ndërsa djali pas lëndimit nuk eshtë në gjendje të vazhdojë punën. Po ja ndajmë 300E. Kush eshtë për që kësaj kërkesë ti ndahet shumën prej 300E? Me vota unanime, kësaj kërkesë i ndahan 300E.

Kërkesa tjetër eshtë nr.02/130 nga Fatime Mazreku, e cila kërkon ndihmë për arsyen e gjendjes së keqë shëndetësore dhe pas operacionit i cili më ka kushtuar 4.000E. Kush eshtë për që kësaj kërkesë ti ndahan 300E?

Me vota unanime kësaj kërkesë i ndahan 300E.

Kërkesa tjetër eshtë nga Liman Ibrahim, i cili kërkon mbështetje me mjete financiare në vlerë prej 2.000E pasi që kam një operim në zemër dhe i kam të vendosura dy stenda. Të bashkangjitura keni të gjitha raportet mjeksore. Kush eshtë që kësaj kërkesë t'i ndahan 300E?

Me vota unanime kësaj kërkesë i ndahn 300E.

Kërkesa tjetër eshtë 02.108 Feride Krasniqi, e cila e ka lëndën jo të plotësuar. Kush eshtë për? Me vota unanime, kjo kërkesë rekomandohet për Kuvend.

Kush e do fjalën te pika të ndryshme?

Urdhëro, Veton!


**Veton Zogaj:** Një kërkesë eshtë bërë nga një qytetar i cili e ka vllaun në burgun e Maqedonisë të cilët e kanë bërë kërkesën për Komitet.

**Argjend Thaqi:** Këtu e kemi kërkesën, mirëpo nuk po dojmë me sjellë kërkesa e mos me kalu. Ne do gjejmë modalitet. Faleminderit për prezencën, këtë seancë e shpalli të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në ora: 12:30.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina



Kryesues i Kuvendit

